



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 191, Datë 06.06.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT
NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS
SIGURUESE) TË ASETEVE TË PALUAJTSHME TË CENTRALIT FOTOVOLTAIK
BLUE 1 NË FAVOR TË GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEST EUROPE S.A,
SICAV-SIF**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, gërma “b”, dhe nenit 10 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1135/6 prot., datë 01.06.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaik Blue 1 në favor të GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEST EUROPE S.A, SICAV-SIF”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 132, datë 07.04.2023 vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të centralit Fotovoltaik Blue 1 në vavor të GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEST EUROPE S.A, SICAV-SIF.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 1135/2 prot., datë 14.04.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për këtë vendimmarrje, ndërsa me shkresën nr. 1135/3 prot., datë 18.04.2023, ERE iu drejtua shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k.

duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së saj dhe duke i evidentuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135/4 prot., datë 11.05.2023, depozitoi në ERE dokumentacionin plotësues.
- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në zbatim të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se dokumentacioni i këtij aplikimi është plotësuar tërësisht si vijon:

Neni 7, “Përmbajtja e kërkesës për transferim”

Pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j” Plotësuar

Pika 3. Plotësuar

Pika 6. Plotësuar

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajjtshme të centralit Fotovoltaik Blue 1 në favor të GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEST EUROPE S.A, SICAV-SIF. (Lista e aseteve bashkëlidhur).
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI


Petrit AHMETI

ANEKSI 1**LISTA E ASETVE TË SHOQËRISË "SPV BLUE 1" SH.P.K.**

Nr.	PËRSHKRIMI	SASIA	SPECIFIKIMET TEKNIKE	VLERA (EURO)
1.	Panel Diellor	103,554	TSM-DEG21C.20 Vertex Dual G lass Bifacial Monocrystalline 650 Wp and 655 Wp	€ 17,659,431
2.	Inverter	177	SG350HX-V115_S Five-hole TB_SG320HX_S_A	€ 2,492,580
3.	Transformatorë	6 1	MVS8960-LV MVS3200-LV	€ 1,538,750
4.	Pilota	19,229	Mikro-pilota ne beton C25/30	€ 1,221,301.91
5.	Struktura	1,832	Tracker VANGUARD 1P	€ 4,702,164.09
6.	Kablo dhe Aksesore (Pajisje LV) + Scada + Sistem CCTV	1,020,361 m	Kablo diellore/Kablo gjenerimi /Kablo për shërbime ndihmëse /Kablo të tensionit të lartë/ Togëzim/Struktura/Kuti kryqëzimi/Ndërtesa/Porta	€ 1,429,867
VLERA TOTALE (EURO)				€ 29,044,094

SPV Blue 1 sh.p.k.

Zenel Hysenbegasi


 Administrator
